


814-1
M 76

Tonin Miloti



Parada e gaforreve

FABULA

8JH-1

M 76

Tonin Miloti

Parada
e gaforreve

FABULA



SHTËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHERI»

Handwritten text at the top right corner, possibly a date or reference number.

Tonin Miloj

Redaktor
DIONIS BUBANI

Piktor
BARDHYL FICO

Parada
e gatoreve

FABULA



Reçensues:
Dilaver Dilaveri
Razi Brahimi

SHKURTË E KËMBËRËVE
SHKURTË E KËMBËRËVE

KAPEDANI

— Pra, unë jam syri

që shikoj brigje e lëndina të gjelbëruara,
qiej e dete, male me kurorë,
hënën kur lundron mes yjesh të pambaruara,
qengjat që harbojnë
e fluturat krahëlëshuara.

— Por shushuritjen e fletëve të blirit,
fyej e zamare e bilbila,
qoftë rrufetë kur nis rrebeshi
apo erën e ëmbël të zefirit,
unë i dëgjoj, — ndërhyri veshi.

— Vërtet, — u përgjegj këmba, — or miq,
po kush ju shpie në ato lëndina,
në pyje e ujëvara të kristalta,
atje ku bora vesh bjeshkët e larta?
Ç'do të bënit ju pa mua, pa më thoni,
se larg rritet sherebelja nga limoni...

— Po qe për limona e portokalle,
për erëza që dalin në kopshtije,
për vjollca, karafila e lulemali,
veç unë, — tha hunda, — u njoh rrënjë e shije.
Pa mua dhe bërsitë, në pisk të diellit,
do kishin sy e faqe për t'u matë
me erën që jep gonxh' e trëndafililit.

— Pushoni, — u tha goja, — o të marrë,
o mburacakë, kapadai, fodullë,
me botën rreth e rrotull lidhem unë
e në kuvende mbaj vendin e parë,
e flas, bërtas, këndoj e jap vendime
që dredhin edhe lisat qindvjeçarë.

Mendja që kish dëgjuar, qetë e qetë,
thirri trurin si një nënë e mirë.

— Pa dil e shih se ç'është kjo mynxyrë,
se fjala fjalën nxjerr dhe nxehet gjaku,
t'i vesh në vend ti shqisa e gjymtyrë,
tregohu se këtu ka zot konaku.


Çdonjëra syresh kryen punë të vyer,
çdonjëra si ushtarët në detyrë
por ti je Kapedani, more bir!



PARADA E GAFORREVE


Në rërë, plisa e shkurre
gjëmuar bori e tambure
e sheshi i juntës fashiste harbonte
se midis këtij rëmeti
kryegaforrja kremtonte
përvjetorin e grushtit të shtetit.
Fjalimi qe furtunë,
ku çdo frazë shoqërohej
me drithma e shkumë!
«Kuadrate të çelikta,
ju gaforre të idhëta,
nga gjeneralët me dekorata

te tetaret këmbëshkathta;
ju që dolët nga errësira e detit,
ju që erdhët nga zgavrat,
nga çufra e rëra e thatë,
jeni radhitur sot
për marrshimin e gjatë
drejt fitoreve
për lavdinë e gaforreve.
Përpara, pra, me ritmin krenar
nën ujë, mbi tokë e nëpër bar!
E mos u stepni
nga llafe e intriga,
nga sytë ziliqarë
e gojët e liga,
që thonë se ne ecim së prapi.
Shkurt hesapi,
ne kemi mënyrën tonë të lëvizjes,
kemi këtë lloj hapi
qysh nga stërgjyshi ynë i vjetër,
kokën para e këmbët n'anën tjetër,
dhe bota, po desh,
le të ecë sipas nesh.»
Gaforre, përpara,
përpara me hapa,
më falni, desha të them,
gaforre përprapa, —
marrsh!



DY VENDIME

Për punë shembullore
në prodhimin e vezëve
pë kuzhina dhe oborre,
për sakrifica deri në heroizëm,
insektet e dekoruan mizën
me medaljen — flori
anti — Di-Di-Ti —



Të nesërmen paradite
Gardalinën e laboratorit
antiinsekticide
e doktor Trumcakun
e qendrës sanitare,
mbledhja plenare
e zogjve, që erdhën truma-truma,
i pushoi nga puna.

ARA DHE KANAĪLI

Parcela e rreshkur për ujë
po digjej si furrë;
ndërkohë në qiell
lundronte një re,
mbuluar nga veli i hollë.

— Pak ujë, pak ujë,
mikesha ime,
se ta shpërblej
me bimë e gjelbërime...

Reja, si grua lozonjare,
kaloi tutje maleve
pa e vështruar fare.

— Ah, re mizore,
thirri ara e zvetënuar;
më duket se erdhi ora
që të vdes nga etja.

ah, e gjora unë, e gjora,
sa më dhimbset jeta!

Kur... ashtu papritur,
parcel' e zhuritur
ndjeu si një freski,
fillad e njomësi,
kudo në damarë,
në plisa, ugarë.
Bima përtërihej,
merrte frymë e ngrihej
e bukur, e gjallë.
Ç'kishte ndodhur, vallë?
Kish vërshuar kanali
me ujërat e gurrës
si dëborë e malit.

— Eh, moj motërzo,
ma dëgjo një këshillë:
nuk jeto het dot
me lypje, mëshirë.
Mua, që zbres nga mali,
më ushqen burimi
që është imi;
jetoj, si i thonë,
me forcat e mia;
nuk pres nga perëndia.

UNË JAM NJË KOKËRR GRURI

Unë jam një kokërr gruri
me peshë miligrami,
por me zemër biluri
e vlera diamanti.

E dua çdo dylm
të butë, qilim,
pa gërryerje, të çara,
me brazda të mbara,
në fushë e kodër,
deri të korrja,
pa më humbur asnjë kokërr.
Me misrin, tim vëlla,
(që zgjatet sa një tra),
me orizin gjithnjë pekule,
e kushërirën fasule,
përbëjmë familjen mbretërore,
që shtrin sundimin
mbi trevat më pjellore
dhe me shumë beteja
në tokat e reja.

Unë jam kryezoti absolut,
por përkulem me nderime
para fshatarit më të thjeshtë
që më bën shërbime.

Këtu qëndron edhe sekreti
nga më buron pushteti,
që kurrë s'perëndon:
Unë rri mbi fron
me kurorën plot kokrra
dhe jo me dokrra...



DELJA KAÇURRELE

Isha delja kaçurrele,
bishti thurur lele, lele,
e peshoja sa një dash,
sa një dash e sa dy dele...



Erdhi dimri, më sfiliti,
fryu era më çkopsiti,
se çobani drekë e darkë
me dy gjethe më gostiti...


Hyri prilli me blerime,
lulëzime e shërrime,
lulëzime qenej si shërrime,
ruk më dukej fëmija ime...

Po e shpëtova qengjin gjallë,
po e nxora në behar,
brigadierit dhe çobanit
s'do t'u jap as qumësht, as dhallë...




PRANË KAÇORRIT TË PULAVE

Mbi natyrë nata po binte,
zonja dhelpër, zvarrë e zvarrë,
rreth kotecit shkonte e vinte,
se mos gjente një të çarë...



Qeni, fshehtë ndër do zhumile,
shpejt e pa dhe i shkoi pranë:
— Mirë se erdhe, zonja skile,
ç'ka të hodhi nga këto anë?

— Uf, ti qenke! Më zu nata
e ndër pyje tani s'dilet,
po kërkoj një vend të për
se, për dreq, janë mbyll, hotelet...
— Ke të drejtë, nuk flihet jashtë,
natë i thonë, ngjall dhe dyshime;
sa për sonte... me ca kashtë
a vjen nga shtëpia ime?
— Kurrë! Se miku i paftuar, —
nisi dhelpra urtë e butë,
e gjen sofrën të pashtruar,
si të duket fjalë e urtë?
— Për fjalë t'urta ka një zyrë,
që mbledh veprat e folklorit;
unë për vete kam detyrë
të mbledh vjedhësit e kaçorrit!



OPINIONE

— Qofsha i gabuar, — tha ujku, —
por sipas mendjes sime
s'ka të drejtë as bariu, as bujku
që më ndjekin për çdo orë
me pushkë në dorë;
se, fundi i fundit,
çfarë i kërkoj unë katundit?
Dy-tri dele a dhi pëlleja
nga mijëra që ka kopeja.


— Qenke i zgjuar, —
iu përgjigj qukapiku, —
të hash pa punuar?
Por kjo është parazitare.
— Pse, ti ç'bën për vete?
— Unë ha krimba dhe insekte,
pastroj gjethe e drurë
që të rriten filiza...

— Eh, po unë s'jetoj dot me miza,
dua mish, bile me dhjamë.

Shkurt hesapi: mot për mot
mund ta ndërroj qimen,
por zakonin s'e heq dot.

— Nuk na the
ndonjë gjë të re...

Si ti është i tërë sorollopi, —
përpara La Fontenit
këtë e tha Ezopi...



PAS STUHISË

Porsa kaloi stuhia e rrezja doli,
kallami me një lis nisi e foli:
— I mjeri ti, të rrahu shiu e era,
kraharoni po të digjet nga rrufeja,
t'i copëtoi moti krahët rreth e qark;
s'i dilet dot furtunës me ballë lart...



— Ìk, ore, tutje... ke gojë të flasësh,
sa fryn një erë përdridhesh e përplasesh,
qysh se ke lindur mban kurriz' përkulur,
e ç'e do jetën zvarrë me kokën ulur?
Edhe një breshkë të hedh në kënetë,
ku kori i bretkosave të pret.
Mua gjoksi më djeg, por jam krenar.
tek unë rri bilbili në behar.
Tani, pra, cila jetë qenka më e mira,
me zhābat në llucë, apo lart me bilbila?



UJKU, QENGJI DHE BLETA

Ju të gjithë e dini atë përrallën e vjetër:
ujku i tha qengjit «Ujt' më turbullove,
prandaj sot vendosa të të ha patjetër».

— Jo, u përgjigj qengji, ti ndoshta gabove
unë pi përposh, zotrote je lart...

Atëherë u hodh bisha — Mos kini qenë vjet?

— Jo, kam lindur sivjet...

— Do të ketë qenë yt atë,
dhe e shqeu shpejt qengjin e ngratë...



Sillet dhe tani ujku grabitqar:

— Qengj, ma turbullove ujin përsëri.

— Përposhtë pi, dikur si im vëlla...

— Lëri arsyetimet, kam tepër uri...

U mat t'i hidhej, por një pushkë krisi
që bishën mizore në greminë bitisi!

Bleta, që kullose mbi një lule blini,
nga skena që pa nxori këtë moral:

«Në botë u dashka bindja, arsyetimi,
por dhe pa pushkë s'u dilka në mal».

N D E S H K I M I

Një gjarpër, që kish veshur një rrobë të re
me pika-pika, hiç pa bërë naze,
po i afrohej kaçubës ku ish një fole,
se i pëlqenin tepër vezët taze.

Lehona thëllëzë para këtij rreziku,
thirri të shoqin dhe të dy tok,
me breshëri çokitjesh iu hodhën armikut
dhe e qorruan, e hodhën për tokë.

Gjarpëri i sfilitur, thirri si përçart:

— Po tani pa sy nga do të vërtitem?

— E, ç'të duhen sytë, — i tha zogu lart, —
apo që të vjedhësh natën edhe ditën...



NJË MBLEDHJE NË STALLË

Aty pasdreke, në stallë,
u bë një mbledhje e gjallë,
që e kryesonte kau.
Erdhi një dele e qau:
— I dashuri Kazil,
përdita po jap qumësht,
por ashtu në rrëmuje,
dikush i shtie ujë.

— Dhe qumështit tim, — tha dhia, —
i shtojnë dy herë nga vija...
— S'durohet, u hodh lopa,
na merr nëpër gojë bota!

— Po flihet mbi dafina? —
ndërhyri një ezmere. —
Atje te magazina
lëvizin dallavere.


Aherë u ngrit kau:

— Në emër të Luanit,
që mungon me sebeb
se kishte një audiencë,
po shpall këtë dekret:
«Me urdhër mbretëror,
kushdo që ndër frymorë,
tinzisht, apo me bujë,
do t'i hedh' qumështit ujë,
dënohet të pijë ujë
me tas, me kovë... po desh
me ujë të thyej përshesh,
me ujë të bëjë qumështore
(që do ta quajmë ujore),
nga uji të nxjerrë gjalpë,
nga uji kos e djathë
(e pastë veten në qafë!).

— Mos është ca e tepruar,
murmuroi një mëshqerrë,
me sy të perënduar.
— Përkundrazi është pak, —
ia priti një mëzat. —
Unë kam një shtesë dekreti,
në qoftë se e pranon mbreti:
Kur matet rrezja e qumështit
e bëhen inventare,
kontrolle e hetime
nëpër procesverbale,
nuk duhen stërhollime
e shkaqe të kërkuara,
plot fjalë të mjegulluara,
që sjellin veç rrëmuje —
se kanë shumë... ujë!

URITHI

- Një urith u fut nën dhe
dhe ia nisi të gërmojë;
i tha rrënja e një lisi:
— Ku do dalësh me këtë lojë?
— Do të hap goxha tunel
nëpër arat me të lashta.
— Po kështu dëmton bimët,
ua nxjerr rrënjët përjashta...
— Si thua ti, të mos punoj,
e të ngordh për një kothere?..
— Të punosh e të jetosh
por jo në kurriz të të tjerëve.



KAU DHE GJARPRI

— Ti je konservator, — po i thoshte gjarpri
kaut, —

i, ore, tërë ditën i bie arës poshtë e lart,
e s'bën tjetër, me shokun tënd në pendë,
veçse tërheq parmendë,
duke hapur brazda në vija të drejta,
po kështu, vallë, do të të shkojë jeta?

— E mora vesh se ç'dashke ti:
që të dukem origjinal
i ti zigzag t'i bëj sot vijat
gjersa të përfundoj në një kanal...



NË TRIBUNËN POLITIKE

UJKU


Unë kam bindjet e mia;
jam zbutur apo jo,
këtë le ta thotë historia.
Sidoqoftë do ta bëj timen,
po nuk i preva thonjtë,
do ta ndërroj qimen.



Do të vishem me rroba vezulluese,
gjithë komça verbuese,
do krihem e do lyhem
me erën e trëndafilut
e do të mbaj mbi vesh
degën e ullirit.

DHEL PRA

Franoj që nga pularia
ka pasur ca ankesa,
bile edhe kërkesa
që t'i lë kotecët në paqë.
Ashtu qoftë.
Dhe kaq.






SKIFTERI

Ky është kulmi,
kjo është shpifje e goditje
se gjoja soji ynë
nuk rron dot pa grabitje.
Pa më thoni ç'të ha:
flutura e insekte
apo gjinkalla-skelete?
Megjithatë,
për hir të harmonisë,
do ta këpus sqepin fajtor...
Le të vdesë nga uria,
të bëhem theror.



GJARPRI

Dhe unë, lëvizi një gjarpër i zi,
që akuzohem për luftë baktoreologjike,
qysh nesër do të vete në farmaci
ta dorzoj helmin vullnetarisht.
Nuk dua të kem gisht
në asnjë ngasje,
në komplete e vrasje.



PESHKAQENI

Dhe për mua
të fryjë erë e zefirit,
të valëzojë deti i gëzimit
dhe ç'janë shoja e belbica,
gjuhsa, sardele,
koca, qefuj e krapuliça,
të notojnë lirisht,
pa kurrfarë frike
në çdo gjerësi gjeografike,
të gëzojnë çdo stinë
në gjiret që farfurijnë.
Unë, që denbabaden
jam quajtur peshkaqen,
këtëj e tutje
me pasaportë e me vulë,
do të quhem «peshkapulë».

BLETA

Kurrë në jetën time
nuk kisha dëgjuar
të tilla premtime e zotime.
Fjalë më të embla se mjalti,
me larmi ngjyrash,
të bukura si flutura,
grishje joshëse e tingëlluese
plot rrezë vezulluese,
ku ligjërata ndërthuret
me figura e stile,
gjithë nuanca e trille.
Ishte diçka dehëse,
bile gjumëdhënëse
me përkundjet e pekuleve,
spërkatur me parfumin
e të gjitha luleve.

Sa keq!

Se gjysma nuk ishin të vërteta,
e gjysma tjetër rrenë të vjetra.
Nënshkruar Bleta!





LIGJËRATA E MAÇES PLAKË

Ndërsa flinte pranë oxhakut,
iu dogj fija e mustakut
një maçoku syjeshil,
që e kish mendjen karafil.
«Tani nuk kam sy e faqe
t'i dal botës pa mustaqe,
e të ngjitem nga çatia,
si gjithë maçokëria!...»

— Mos e bëj gjithaq' hata,
(i tha e ëma, kur e pa),
burrëria e trimëria,
mendja e mpreht' e bujaria,
nuk i mat kush me mustaqe,
a i ke shkurt, a leqe-leqe.


Unë kam njohur, daca shpesh
me mustakë nga veshi n'vesh,
që nuk kapin dot një mi
e vec, dinë të hanë përshesh...

VEZA

U çudit gjithë mëhalla,
kur u hap fjala
se gjeli kish bërë vezë!
Në klubin e pularisë
u ndez një debat i zjarrtë,
që vazhdoi gjatë e gjatë.

Veza që e bardhë, e bukur,
por ai që e bëri
nga që zhdukur,
pse rrinte strukur?

Asaj ane
u ngrit një çalamane
e pyeti me gjysmë zëri:
— A e bëri, a s'e bëri?
— Si guxon të dyshosh,
thirri një kaposh,
këtu ka një procesverbal,



sa një çarçaf,
me firmën më të nderuar
që vërteton
ditën, orën e vendin e caktuar,
ku gjeli bëri atë
që s'ishte parë e dëgjuar.

— Dale, ndërhyri një pikalare,
ta marrim qetë e qetë,
se në të vërtetë,
ka disa
që me fjalë lënë nam,
e bëjnë, jo vezë,
po hipopotam.

— E çdo të thuash? —
pyeti një gjumashe e përhime,
— Sipas mendjes sime,
ngjall mjaft dyshime...

— Domethënë, ne bëjmë gjumë?
— Epo nuk është herë e parë
që besohet një copë letër
më tepër se një vepër...

— Dua fakte,
prova materiale.
— Po veza që ke përpara?
— Është tepër banale.
— Ky është kulmi,
thirrën tre gjela fistrakë,
një fyerje e tillë
lahet vetëm në gjykatë.



— Eh po, — tha pula plakë, —
lumi që ju mori,
po dijeni se po i çoni gjyqit
një vezë inkubatori.

KANARINA PEDAGOGE

Për të parën herë
doli para publikut të gjerë,
bilbili i vogël me violinë në dorë.
Në radhët e para të sallës pyjore
qëndronin:

Gjëli me lafshën plot ngjyra,
drejtori i teatrove verore,
dy sorra, sqepthikë,
një gazetare gjinkallë,
tre garguj kritikë
dhe kanarina — pedagoge nga profesioni,
që i dridhej gusha nga emocioni.
Mbi degën e një lisi lart
rrinte bilbili plak
e bilbilesha nënë,
që ndiqnin me vëmendje
vogëlushin në skenë.

.
Dhe nisi melodia,
lehtë e lehtë.
si dritëza e hënës

që bie mbi flebë,

si nina-nana

që përkund foshnjën

e erdhi e u rrit,

me hove shkëlqimi,

si rreze agimi.

Shpezëria shpërtheu në brohori

për talentin e ri.

— Pa hë? — pyeti gjeli me ngadalë.

— Pranueshëm, — tha zonja gjinkallë, —

ka zemër më shumë se logjikë,

do frena e shkreta muzikë!

— Ashtu, — vazhdoi një sorrë, —

s'e ka sigurinë në dorë.

— Po, — tha një këmbëçale,

në fushë profesionale

lë për të dëshiruar,

violina nuk është qiri që meket,

as tambur që dridhet si i tërbuar.

.

Kanarina e shkretë

po dridhej si purtekë,

kur iu afrua bilbili dhe i tha:

— Jo se është im bir,

por ti vërtet ke punuar mirë:

e mos harro se notën

nuk e jep gjinkalla,

por salla.

Bilbilesha i vuri në gushë një karafil.

— E dashur, unë linda një zog,

por ti rrit një bilbil.

— E dashur, unë linda një zog,

por ti rrit një bilbil.

— E dashur, unë linda një zog,

por ti rrit një bilbil.

— E dashur, unë linda një zog,

por ti rrit një bilbil.

— E dashur, unë linda një zog,

por ti rrit një bilbil.

— E dashur, unë linda një zog,

por ti rrit një bilbil.

— E dashur, unë linda një zog,

por ti rrit një bilbil.

— E dashur, unë linda një zog,

por ti rrit një bilbil.

— E dashur, unë linda një zog,

por ti rrit një bilbil.

— E dashur, unë linda një zog,

por ti rrit një bilbil.

— E dashur, unë linda një zog,

por ti rrit një bilbil.

— E dashur, unë linda një zog,


por ti rrit një bilbil.

— E dashur, unë linda një zog,

por ti rrit një bilbil.

DALLËNDYSHJA DHE GOMARI

Një dallëndyshe, me shpejtësi rakete,
kapi në ajër një flutur ngjyra-ngjyra.
— Lëshoje, — i tha gomari, — ku e gjete,
me të kënaqemi si ne edhe natyra.



— Gomar, — ia priti zogu, — me sa duket
nuk merrke vesh nga shkencat biologjike,
se kjo, që vesh fustane fantastike
e shkon lule më lule kur bie bryma,
nuk pjetë kërriçat si ti, por mijëra krimba...

Dhe mos harro!
kërriçat e tu na duhen, —
krimbat jo!






AAAAA

AAAAA

KORBI THE DHELPA

Siç e kanë treguar,
shumë kohë para meje,
korbi i zi
kishte vjedhur një copë djathë
dhe po e hante mbi çati.
Dhelpra atje poshtë,
duke u lëpirë,
zu t'i thosh:



— Sa i bukur, sa i mirë,
puplat të ndrijnë si nur,
po zërin ama
nuk ta kam dëgjuar kurrë...
Korbi e vuri djathin
mbr një tjegull
e i tha:


— Zonja skile,
çfarë kënge kërkon,
domethënë ç'loj muzike,
të lehtë a klasike?

— Po tallesh, më duket...:

— Për nder, joni...
Do të këndoju, fill pas buke,
nga opera e Don Bazilit
arieni...
«S'e ha atë kokërr ulliri».

GOMARI DHE LEPURI

Unë, që quhem lepur,
me lëkurë të butë
e të përhimtë,
sipas një studimi të imtë,
kam arritur në përfundime
se ti, gomar,
rrjedh nga raca ime.



Në epokën e gurit
edhe ti bridhje pyjeve
e flije nën dritën e yjeve,
ishe i shpejtë vetëtimë
e zërin s'ë kishe të çjerrë,
por të ëmbël violinë.
Kur u zbutë
e ndërtovë stallë,
domethënë
kur kalovë nga lepur në gomar,
të nisën edhe taksiratet;
të vunë samar,
shenjë kjo
që ti ishe dënuar
të rrosh i ngarkuar.

— E para e punës, —
u përgjigj gomari, —
nuk dihet në mënyrë ekzakte
se kush erdhi i pari
në botën thundrake.
Ngjasojmë diçka nga veshët,
që i kemi në formë konike,
por një tezë e tillë
më duket empirike.
Se, për shembull;
edhe ti, edhe luani,

jeni kafshë gjitare,
por kjo s'do të thotë gjë fare,
se ti i ngjet atij
sa i ngjas unë bilbilit
në melodi.

Përfundimi është ky:
Unë jam gomar,
por jo budalla,
e vuaj vetëm nga ata
që mbi kurrizin tim
duan të kthejnë
kohën e gurit
në kohë të drurit...

NË GJYQ

— E përse mendon të ndahesh? —
pyeti Ariu, kryetari.

— Po, pikë së pari
Lepurushka është grindavece,
gjuhëspece,
nuk di të sillet në shoqëri,
as në shtëpi,
të gatujë, të lajë leveret;
shkurt, nuk na puqen karakteret.

— Ti ç'ke për të thënë?

— Unë. e ç'të them më parë ...
eh, zoti kryetar ...

kur isha e re
më deshi e më mikloi,
po tani që kemi një qerre fëmijë
dhe unë u plaka para kohe
nga puna,
im shoq nisi të ftohet
e të largohet.


Se nga bredh nga mëngjesi
e derisa erret,

e pastaj thotë
se nuk iu puqkan karakteret.



HARUSHË BARDHA

Harushë Bardha, që punon në cirk
si fotografe,
po i qahej njëherë qenit:
— More mik,
disa picirukë
s'janë aq të kënaqur për fotot e mia,
sidomos nga cilësia.
Nuk dua t'i fsheh të metat,
po pse nuk, shohin gazetat
që botojnë pamje nga grigja fshatarake
ku s'dihet a janë pula,
a dythundrake...
E kaq dalin të mjegulluara
disa klishe t'uruara,
sa mos t'ishte përposh fotografisë
shënimi i redaksisë,
një ditë atë veterinerin —
djalin e Mistos —
gati e mora për Kontin e Montekristos.



REKOMANDIMI

Në shoqërinë atletike «ZABELI»,
ku stërviten kafshët e garave të shpejtësisë,
ia behi një ditë breshka,
me lutje në dorë,
që ta pranonin anëtare
pa bërë asnjë provë.

Kaprolli mblodhi kryesinë,
e cila e refuzoi njëzëri
si të ngathët e pa perspektivë.

— A jeni në vete, u hodh skilja,
ajo ka t'ardhmen përpara.
për vrapime e gara
e do të na nderojë
në spartakidaën verore
që fillon së shpejti
në zonat pyjore...


— E ku mbështetesh ti? —
ndërhyri një kunadhe.

— E ç'e do provën më të madhe,
kur ka përkrahjen e thiut
dhe rekomandimin e ariut...

DERRI DHE DOSA

Derri zbuloi disa bërsi prej rrushi
e ra mbi to, ashtu si bie një derr;
e ha e pi, pa ia zënë n'fyt askushi,
gjersa u err.

Sa ktheu në thark ia dëgjoi erën dosa,
«Më duket, tha me vete, paska pirë»...
— Hë shpirt i përvëlur? — i tha e shoqja, —
Sikur s'më dukesh mirë.



— Ia shtrova, grua e dashur, dhe jo pak
por të bëj be për krye të gicës Lare,
nuk më rëndoi në kokë as në stomak,
jam qiçër fare...

— Duket ke gjetur mjik në magazinë,
— Pikërisht mungonte ai... dhe thuaj shyqyr,
që s'kish arritur ta përziejë bërsinë
me ujë e me qymyr...

BRUMBULLI DHE BUBURRECA

— Habitem, —

i thosh brumbulli një buburrece, —
si rroni aq shtrënguar
në një dhomë përdhese
dy me dyzet centimetra;
ku lani e shplani njëra e tjetra
ku rrini e hani,
fëmijtë si i rritni, ku i lini,
ju ku pritni vizita, e ku flini,
a grinden kunatat me shoqja shoqen,
a kapen flok për flok si shtrigat;
më thuaj a kërcët potera,
thashethemet dhe intrigat?

— I shkreti ti, o brumbull,
qenke vërtet kungull,
po a nuk di, o i ngratë,
se ne punojmë ditë e natë...
— Punoni si jo, bile shumë

po pastaj?

— Pastaj, ore lum vëllai,

a e mendon

se atij që punon

nga mëngjesi e derisa erret

i dilka kohë të merret

me pëshpëshe ndër qoshe,

thashetheme e punë boshe?

DEKRETI

«Njoftohen të gjithë sa janë:
njëthundrakë e shtatthundrakë,
sisorë e leshtorë,
puplakë e fluturakë,
rrëshqanës e uxorë,
brejtës e gërryes,
me bisht e pa bisht,
se u ndalohet rreptësisht
martesa me dy gra».

Nënshkruar
n'emër të Luanit besnik
Ariu putërçelik.

— Unë për vete, — tha pëllumbi, —
dua një pëllumbeshë
e me të do të lidh martesë,
do të rrit fëmijë
e do të jetoj në harmoni.



Po si do t'ia dalë
zoti këndez,
që ka mbushur me gra
plot një qymez?

— E po, hori, do ta kthejë ndryshe,
ia bëri një dallëndyshe.

— Pa tjetër, — shtoi fazani, —
ai që s'ka fytyrë

gjen mënyrë,
rrugë e shtigje
që të kalojë mbi ligje.

— Po si? — u hodh prapë pëllumbi.

— Me dredhira... ashtu nën dorë,
pulën plakë e mban me ligj,
kurse të rejat pa kurorë...

NË KËMISIONIN E PROVIMIT


Para komisionit muzikor
në fillim u paraqit
grupi i patave në kor,
pastaj një kanarinë,
një trio pulash, dy turtuj
e një gardalinë.

Gjeli, me atë lafshë krenare,
solo, në trombo, e tundi fare...
Doli edhe një pëllumbeshë
hirëplote, e veshur për bukuri,



që këndoi arien «gu-gu-gezhë»
nga akti i tretë i operës «Lulet e Spanjës»,
kompozuar nga e ëma e Zeqos majë thanës.
Bilbili, kryetar komisioni,
i tha së shoqes me ngadalë:

— Kjo çupë ka bukuri të rrallë
dhe sikur të qe djali ynë më i rritur,
për nder s'do kisha pritur,
por ia merrja nuse që sot,
veç në konservator, ama,
nuk e pranoj dot.



LLOKUMET

Një dorë e fshehtë
i fali lumit llokume dinamiti
që vrau qindra bërsakë
e zhduku mijëra vezë.

Një mlysh
që ish fshehur në zgavrën e shkrepit
e i shpëtoi tërmetit
tha:


— Kujtoja se llokumet dhurohen
për lindje, fejesë a pikëpjekje.
e jo kurrë për vdekje.

NGJALA

Një ngjalë,
me shoqe shumë,
u nis nga deti i Karaibeve,
kaloi oqeanin valëshkumë
dhe nga bregu i Bunës
hyri në liqen,
plot gaz e shënd.
Aty pa një krimb që varej
dhe e gëlltiti, pa u menduar.
Po krimbi fshihte grepin
dhe ngjala u dorëzua.
ama duke filozofuar:
«Të udhëtosh dhjetë mijë kilometra
për të ngrënë një palo krimb,
kësaj nuk i thonë uri,
po marri».

URA E FSHATIT

Tek ura e fshatit,
që ish ngritur mbi përrua,
erdhën dy gomerë ngarkuar
dhe lexuan në krye:
«Kjo urë mban 500 kilogramë».
— Kalojmë se jemi taman, —
tha njëri hajvan. —
— Më mirë një nga një,
ia bëri urë e urtë,
do të jeni më të sigurt.
— Moj, të dy dhe me revan...
...Por parmaku bëri bam
dhe kafshët, nga një e çarë,
ranë në përrua me gjithë samarë.
Kur dolën në breg,
me brinjë të thërrmuara:
— Na gënjeu, thanë, ajo e shkruara
në tabelë.



— Jo, — u përgjegj ura menjëherë, —
shënimi është i saktë,
veçse, more të mjerë,
unë s'mbaj dot
500 kilogramë gomerë.

KËNGË E ZEMRËS

I hipur mbi një degë lisi
bilbili ia nisi
këngëve të zjarrta;
njëherë me nota të larta,
pastaj më shtruar,
zërin duke e lëmuar
porsi violinë.
Diell, erë e kroje u shkrinë,
pylli sikur nuk merrte frymë.
Në kulmin e ngazëllimit,
kur shpezë e shtazë
ishin si n'ekstazë,
gomari ia dha një pëllitje
me njëfarë çoroditje,
sikur përplasën në qoshe
njëqind tënxherë boshe.
— Mbaje veten, orë guak,
i foli rëndë një trumcak,
si ke guxim t'i dalësh përpara



mjeshtrit të harmonisë,
 yllit të melodisë.


— E di, — tha gomari, — e di,
 zërin, s'e kam të bukur,
 por ç't'i bëj zemrës,
 që digjet në kraharuar.
 Kënga është si një mesazh
 për niken qimelëmuar.

— Aherë paske hak,
po a nuk ia merr më lehtë,
siç thuhet në «sordinë»?...

— Jo, soji ynë nuk di
ta fshehë dashurinë,
dhe nuk përmbahet dot:
atë që ka në zemër
e thotë me gojën plot.

ARRA

Me ata sy dinakë e vezullues
me ato faqe, mermer i lëmuar,
me atë ballë të mprehtë e kërcënues,
po sillej një sëpatë nga bregu i arës.
ku kishte hapur degët trangu i arrës.
E kur u ngrit mbi bisht për të qëlluar
dëgjoi zërin e saj duke vajtuar:



— Mos më godit se dua të rrit filiza,
e çfarë më kërkuan u dhashë,
a deshën degë për të bërë korniza,
a deshën frutin tim, u dhashë me thasë,
gatuan me to nuset bakllava,
nga thelpinjtë nxorën dhe vaj për t'u lyer,
nga mishi i kokrrës liko e reçel,
me gjethin tim çorapë keni ngjyer.
Tani mos kërkoni edhe jetën time,
të digjem në ndonjë vatrë kuzhine?
Sopatën e pikëlloi kjo ligjëratë
dhe iku e ra mbi një trung të thatë.

KËRMILLI

Udhëtoi kërmilli gjith' natën e natës
në kopshtin me lule e bimësi;
në mëngjes hipi mbi tufën e kashtës,
rruga që kish përshkuar ndriste flauri.
— Ja, — tha gjith' shend e gaz, —
ngado shkel unë lavdia më ndjek pas.
Nesër do të më marrë historia
se pa djersirë fare
u ngrita një përmendore veprave të mia.
Mirëpo afroi agimi,
u zhdukën hijet e natës
dhe lavdia e kërmillit
u shua sapo ra rrezja e diellit.

ZOGA E RE

Pula pikalare
i shkroi gjelit të komshisë,
një letër
ku i shprehte me dufe e zjarre
gjithë afshin e dashurisë.
«Qysh ditën që të pashë,
mbi avlli,
s'kam mbyllur sy,
nuk ha e nuk pi
e bile nuk bëj as vezë,
se zemra ime është' ndezë
për kaçiruben tënde të kuqe,
që ngjan me një burbuqe.
O gjeluci im i shtrenjtë,
o gushëzambak,
më duaj si të dua,
se po shkrihem nga merak.»
Gjeli e mori letrën dhe e lexoi
e pastaj shtoi:
«Sa shkrim të keq paska,
me gërma si këmbë pleshti,

s'dihet ku nis e ku mbaron rreshti.
Lumi që e mori,
këtë kartë,
ngjan me recetë doktori.»
E ndërsa zoga e re
priste dashurinë,
kokoshi kërkonte kaligrafinë.

F T E S A

Maçoku mustaqefshesë
mori këtë ftesë:

«Me rastin e martesës së djalit tonë
MIUT HUNDËSHPATË
me zonjushen **MIUSHË**, bij e respektuar
e **MIJVE BISHTGJATË**,
jeni të ftuar
me gruan tuaj të nderuar».

Nga familja e **BREJTËSVE TRIMA**
Bodrumi numër tre, hyrja nga vrima.

— Ashtu ë... dhe «trima», s'e dija më parë,
mor do t'ju rrjep lëkurën çikë-çikë,

me dhëndër, nuse, krushq e kumbarë...

Merr djalin, grua, t'u shkojmë për vizitë.

— Mjau, mjau... gërr! O zoti Mi,

hape, bre, portën, jam milku yt...

— Hyni nga vrima, aty karshi.

— Vrimën e shohim, po s'futemi dot.

— Atëherë rrini jashtë, takohemi pas buket,
s'do ta rrëzoj për ju murin e portës...

— Na e hodhi më duket,

ia bëri daci bashkëshortes.

— Më prisni këtu, tha maçoku i vogël,
e t'u bë si ngjalë sa kaloi vrimën.

«Bobo! Ç'dasmorë, surle e lodër,
e t'u vërsul mbi ta e bëri kërدينë...

Një Mi i zgjuar, që shpëtoi gjallë,
duke u kacavarur mbi çati,

mori ditarin e shkroi këto fjalë:

«Ç'ka lind nga macja gjuan mi».

GJINKALLA

As pëllumbi për pëllumbeshën,
në kuvli a mbi pullaz,
as bilbili për bilbilëshën,
që thonë shkrihen në ekstazë,
me gjinkallën s'mbaten dot,
kur ia nis këngës zemrore,
me aq trille, dufe e afshe,
dridhen fusha e bregore,
gjëmojnë përroje e jehojnë pyje,
ndizen shpate e lugina
në një kor të pambaruar,
që kur lind rreze e beharit,
gjersa dielli faqendritur
shkon e fshihet prapa malit.
Këndon djali i gjinkallës
për atë që dashuron,
i dhuron këngën e krisur,
që po nisi nuk pushon,
sikur rreh një mijë kazanë
me shkopinj e me çekanë.
«Pashë krojet ujëfloriri,

pasha gazin që fal lili,
 nënës s'vet po i thotë bilbili:
 nuk durohet kjo «Muzikë»
 që shpon tëmthet porsi thikë.
 Edhe rrahja e një legeni,
 edhe lehja e një qeni
 ka më tepër melodi.
 — Ka të drejtë, tha shpezëria,
 s'është këngë, as është vaj,
 por një zhurmë... dreqi ta hajë!
 Dhe jo vetëm kanarina
 delikate, shijehollë,
 gushëkuqi, gardalina,
 ishin mbushur me maraz,
 por edhe kërrici i gomarit
 tha: s'durohet ky avaz!
 «Le t'i thurim një padi
 e ta hedhim fill në gjyq,
 propozoi një zog i ri;
 tërë ditën cinxërima,
 po na ndahet dysh kaptina
 e ta themi fare sheshit,
 na u prisht timpani i veshit.»
 Bilbilesha qafëlëmuar,
 këngëtare e dëgjuar,
 tundi gushën e kuvendi:
 — Pa dëgjoni, o puplashkruar,

që gjinkalla këndon keq,
këndon keq, bile për dreq,
këtë e di dhe një gomar,
pa le ju zogjtë këngëtarë.
Por a e dini një sekret
se gjinkalla lind e shurdhër
e s'e ndien zërin e vet.
Pra i bie daulles kot,
lind e vdes e s'dëgjon dot.
S'e peshojmë, as e gjykojmë.
Ah, po neve akuzojmë
sorrën, korbin, çirikokën,
që përdita na çajnë kokën
duke e ditur fare mirë
se këndojnë veresi
si teneqja për në shi.

*

*

*

Nga kuvendi i zogjve t'malit
doli qartas dhe morali:
S'është i keq as bufi i kënetës,
por do t'ishte një shëmtirë
po t'i mbushte mendjen vetes
e të nisej e stolisej,
duke u lyer e zbukuruar
për t'u shitur pëllumb i shkruar.

P E R M B A J T J A

Kapedani	3
Parada e gaforreve	5
Dy vendime	7
Ara dhe kanali	9
Unë jam një kokërr gruri	11
Delja kaçurrele	13
Pranë kaçorrit të pulave	16
Opinione	18
Pas stuhisë	20
Ujku, qengji dhe bleta	22
Ndëshkimi	24
Një mbledhje në stallë	25
Urithi	28
Kau dhe gjarpri	29
Në tribunën politike	30
Ligjërata e maces plakë	36
Veza	38
Kanarina pedagoge	42
Dallëndyshja dhe gomari	45
Korbi dhe dhelpira	47
Gomari dhe lepuri	49
Në gjyq	52
Harushë Bardha	54
Rekomandimi	55
Derri dhe dosa	57
Brumbulli dhe buburreca	59
Dekreti	61
Në komisionin e provimit	63
Llokumet	65
Ngjala	66
Ura e fshatit	67
Këngë e zemrës	69

Arra	72
Kärmilli	74
Zoga e re	75
Ftesa	77
Gjinkalla	79

M. J. ...

(M. J. ...)

(M. J. ...)

M. J.



KONKORDIJA POLKRAVJE — SHIPKROVJE e R
TAVRE, 1907.

Miloti, T.

Parada e gaforreve. — Fabula — [Red.:
D. Bubani, Pikt. B. Fico]. T., «Naim
Frashëri» 1987.

84 f. me il.

(E. m.): 891.983-191

(E. v.): 891.983-1

M 76



Tirazhi 1500 kopje Format 70x100/82 Stash 2204-82

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re
Tiranë, 1987.